



Pranuar më: Priljevoj:	10.12	2024
Njësi: Jednica	Numri: Broj	Shtesa, Dodatak
05-453101-60560		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Neni 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe neni 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS shpallë:

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ(Klube dhe Shoqata Sportive)

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 mbi kriteret,standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1.Drejtoriati për Kulturë,Rini dhe Sport bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare (Klubet dhe Shoqatat Sportive) të Regjistruara në Republikën e Kosovës që selin dhe adresën e Klubit apo Shoqatës e kanë në territorin e Komunës së Lipjanit që programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në **zbulimin dhe promovimin e talentëve të rinj të Sportit në Komunën e Lipjanit.**

2.OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

2.1. Klubet dhe Shoqatat Sportive të cilat bëjnë gara (**me kategori të reja**) zyrtare në Federatat përkatëse të licencuara nga Ministria e Kulturës,Rinisë dhe Sportit.

3.Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një project përmë aktiviteteteve si më poshtë:

3.1.Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve locale,institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin e aktiviteteteve sportive **zbulimi dhe promovimi i talentëve të rinj në sport.**

3.2.Aktivitete që synojnë avancimin e politikave locale dhe qeveritare në fushën e avancimit dhe promovimit të sportit.

4.Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **30.000.00 euro.**

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo project është **501.00 euro**, ndërsa shuma maksimale për një project është **3.000.00 euro.**

5.Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë dhe përfundon me **27.12.2024.**

6.Klubet dhe Shoqatat Sportive mund të aplikojnë më së shumti me një (1) projekte në kuadër të kësaj thirrje,ndërsa periudha e zbatimit të projektit është për 6 muaj (180 ditë).

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare (Klubet dhe Shoqatat Sportive) me Seli dhe Adresë në Komunën e Lipjanit së paku **një vit** para dates së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e zbulimit dhe promovimit të talenteve të rinj në sport.

Klubet dhe Shoqatat Sportive duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (web faqen www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për Shërbim të Qytetarëve nr.1 dhe nr.2.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar Brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën (uran.qeriqi@rks-gov.net)

Lipjan, më 10.12.2024

Anila Reçica Llugini
Drejtoreshë e DKRS-së

